



**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

***Qeveria-Vlada-Government***

*Ministria e Punëve të Brendshme-Ministarstvo Unutrašnjih Poslova-Ministry of  
Internal Affairs*

Akademia e Kosovës për Siguri Publike / Kosovska Akademija za Javnu  
Bezbednost / Kosovo Academy for Public Safety

---

# **KOMISIONI PËR SIGURIMIN E CILËSISË**

## **PLANI VJETOR I AKTIVITETEVE PËR VITIN 2026**

## PLANI VJETOR I AKTIVITETEVE TË KSC

Qëllimi i këtij plani është të përcaktojë aktivitetet kryesore të Komisionit për Sigurimin e Cilësisë për vitin 2026, me synim forcimin e sistemit të sigurimit të cilësisë, përmbushjen e standardeve të Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), harmonizimin me Standardet Evropiane për Sigurimin e Cilësisë (ESG), përmbushjen e standardeve të Autoriteti Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), harmonizimin me Standardet e Sistemit të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK), si dhe përmbushjen e standardeve ndërkombëtare institucionale të IADLEST (SHBA). Mbi të gjitha qëllimi kryesor i këtij plani është avancimi i kulturës së cilësisë në fushën e sigurisë publike.

### Objektivat kryesore

- Zhvillimi dhe monitorimi i planifikimit strategjik institucional për sigurimin e cilësisë;
- Përcaktimi dhe përditësimi i standardeve të sigurimit të cilësisë në kuadër të Politikave të Sigurimit të Cilësisë;
- Mbështetja dhe mbikëqyrja e proceseve të akreditimit dhe ri-akreditimit;
- Rritja e transparencës përmes publikimit të raporteve vlerësuese;
- Avancimi i kulturës së cilësisë në të gjitha nivelet institucionale.

Njëkohësisht ky plan përcakton kornizën e punës së KSC brenda të cilat duhet të angazhohen në aktivitetet përkatëse si dhe proceset që duhet zhvilluar dhe hapat e mëtutjeshëm deri në arritjen e rezultateve. Për përmbushjen e këtij plani KSC do të angazhohet në menaxhimin e punës dhe bashkërendimin e aktiviteteve në funksion të sigurimit të cilësisë.

## AKTIVITETET E KOMISIONIT PER SIGURIMIN E CILESISE 2026

Takimi i KSC	Aktiviteti	Veprimet konkrete të KSC	Rezultatet e pritura
<b>Takimi I (TM I)</b>	Shqyrtimi i raporteve vlerësuese të programeve trajnuese	<ul style="list-style-type: none"> <li>- shqyrton raportet analitike;</li> <li>- adreson raportet për publikim;</li> <li>- jep rekomandime për përmirësim</li> </ul>	Raporte të shqyrtuara, të adresuara dhe të gatshme për publikim
	Shqyrtimi i politikave të sigurimit të cilësisë	<ul style="list-style-type: none"> <li>- analizon politikat ekzistuese;</li> <li>- identifikon boshllëqet dhe nevojat për përmirësim;</li> <li>- jep udhëzime për rishikim;</li> </ul>	Bazë e qartë për rregullore dhe politika të përmirësuara
<b>Takimi II (TM II)</b>	Shqyrtimi i raporteve të vetëvlerësimit akreditues	<ul style="list-style-type: none"> <li>- analizon RVV institucionale dhe programe;</li> <li>- jep komente dhe rekomandime për përmirësim</li> </ul>	Raporte vetëvlerësimi të konsoliduara dhe në përputhje me standardet
	Shqyrtimi i rekomandimeve nga sigurimi i jashtëm i cilësisë	<ul style="list-style-type: none"> <li>- analizon rekomandimet e Institucioneve vlerësuese vlersuese;</li> <li>- prioritetizojnë rekomandimet;</li> <li>- adreson tek njësitë përkatëse</li> </ul>	Lista zyrtare e rekomandimeve të adresuara dhe të prioritetizuara
<b>Takimi III (TM III)</b>	Hartim i planit të veprimit për vlerësimin e impaktit të trajnimeve -sipas modelit Kirkpatrick niveli 3 dhe 4	<ul style="list-style-type: none"> <li>- analizon demografine vlerësuese;</li> <li>- shqyrton pyetesoret dhe formatin e shpërndarjes;</li> <li>- adreson pyetesoret vlerësues tek ISP-të përkatëse;</li> </ul>	Pyetesoret të adresuar-informatë kthyesë e pranuar, raport i hartuar
	Këshillimi për programe, module dhe standarde arsimore	<ul style="list-style-type: none"> <li>- jep rekomandime për përmirësimin e programeve dhe moduleve;</li> <li>- harmonizon zhvillimet me nevojat operative</li> </ul>	Programe dhe module të përmirësuara dhe të harmonizuara
<b>Takimi IV (TM IV)</b>	Monitorimi i zbatimit të rekomandimeve dhe planeve përmirësuese	<ul style="list-style-type: none"> <li>- shqyrton raportet periodike të monitorimit;</li> <li>- vlerëson progresin e njësisë;</li> <li>- propozon masa korrigjuese</li> </ul>	Evidencë e qartë e përmbushjes së rekomandimeve
	Raportimi vjetor dhe promovimi i kulturës së cilësisë	<ul style="list-style-type: none"> <li>- shqyrton raportin vjetor të cilësisë;</li> <li>- jep rekomandime</li> <li>- propozon prioritetet për vitin pasues</li> </ul>	Raport Vjetor i miratuar dhe bazë për planifikimin e vitit vijues

\*Plani Vjetor i Punës së KSC në AKSP u miratua në takimin e datës 16.02.2026